



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**  
**DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Tiranë, më 17.1.2025

**NJOFTIM PUNËSIMI**

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe të në VKM nr. 19, datë 9.1.2025, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuar si më poshtë vijon:

➤ **DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE**  
**SEKTORI I PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE KOMBËTARE**  
4 SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë)

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Kryen kontrollin dhe vlerësimin administrativ të dosjeve të aplikimit për skemat e mbështetjes kombëtare dhe dërgon për miratim tek përgjegjësi i sektorit, në zbatim të manualit të procedurave, udhëzimet përkatëse dhe legjislacionin e zbatueshëm.
2. Harton njoftimet me shkrim për aplikantët (sipas rastit) për vendimet që merren për aplikimin e tyre nga drejtoria.
3. Merr pjesë në hartimin e kontratave për aplikimet e pranueshme, si dhe amendime kur janë të pranueshme në zbatim të manualit të procedurave, udhëzimet përkatëse dhe legjislacionin e zbatueshëm.
4. Trajton kërkesat e deleguara nga përgjegjësi i sektorit të ardhura nga aplikantët/përfituesit për skemat e mbështetjes kombëtare.
5. Raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe drejtori i drejtorisë mbi kryerjen e detyrave kryesore të përcaktuara.
6. Merr pjesë në hartimin dhe ndryshimin e manualeve të procedurave të drejtorisë sipas udhëzimeve të përgjegjësit të sektorit.
7. Identifikon dhe raporton parregullsitë/red flag e hasura gjatë procesit të punës në përputhje me manualin e procedurave.
8. Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

- Diplomë e nivelit “Bachelor” në Shkenca Ekonomike, Shkenca Juridike, Shkenca Natyrore ose Shkenca Bujqësore. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- VKM nr. 719, datë datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Udhëzimin e Skemave të Mbështetjes Kombëtare.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 21.1.2025, ora 16:30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

---

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**